



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren Fakulteti i Filologjisë

PROGRAMI MËSIMOR						
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Gjuhë e letërsi shqipe	Viti akademik	2021/2022	
LËNDA		Gjuhësi e përgjithshme				
Viti	3	Statusi i lëndës	obligative	Kodi		ECTS kredi
Semestri	5		4			
Javët mësimore	15		Orët mësimore		Ligjërata	Ushtime
					2	1
Metodologjia e mësimit	Lënda e <i>Gjuhësisë së përgjithshme</i> do të zhvillohet në 2 orë ligjërata dhe 1 orë ushtime, në javë. Do të përdoren metodat frontale dhe ndërvepruese, si ajo e bashkëbisedimit, e komentimit dhe vlerësimit, e argumentimit, e analizës dhe e sintezës. Studentët udhëzohen të përdorin literaturë shkencore dhe të debatohet për to. Lënda zhvillohet me ligjërata, ushtime, interaktivitete, teste, seminare.					
Konsultime						
Mësimdhënësi	Prof. ass.dr. Flamur Shala		e-mail	flamurshala@yahoo.com		
			Tel.	044 509 272		
Asistenti			e-mail			
			Tel.			

Qëllimi studimor i lëndës	Përfitimet e studentit
<p>Lënda ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të kuptojnë drejt se <i>Gjuhësia e përgjithshme</i> është njëra nga lëndët bazike e cila ka lidhje të ngushtë me <i>historinë e gjuhës shqipe</i> dhe se mësimi i kësaj lënde i bën të zotë studentët të dinë për nocionet, kategoritë dhe teoritë e gjuhësisë. -Të ngrejnë nivelin e përgjithshëm mbi gjuhësinë e përgjithshme, mbi teoritë moderne të gjuhësisë. -Të identifikojnë, të kuptojnë dhe të zbatojnë konceptet dhe teoritë nga fusha e gjuhësisë së përgjithshme. -Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre. -Të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e gjuhësisë së përgjithshme. -Të aftësohen për punë kërkimore-hulumtuese individuale e grupore. -Të zhvillojnë aftësitë për të gjykuar, krahasuar, analizuar, sintetizuar etj. 	<p>Pikësnyimi kryesor i lëndës është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të kuptojnë se <i>Gjuhësia e përgjithshme</i> është lëndë e pandashme nga degët e gjuhësisë, fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës së gjuhës dhe se dija për të nënkupton një dije të mirëfilltë mbi nocionet, kategoritë dhe teoritë mbi gjuhën, brenda sistemit gjuhësor. -T'i përvetësojnë dhe t'i dallojnë mirë nocionet themelore të gjuhësisë: -Ta kuptojnë përkufizimin e gjuhësisë; -Të njihen me historinë e gjuhësisë; -Me gramatikën tradicionale; -Me gjuhësinë krahasuese; -Me zhvillimet evolutiveve të gjuhëve; -Me gjuhësinë moderne; -Me gjuhësinë strukturaliste; -Me diakroninë dhe përshkrimin sinkronik të gjuhëve; -Të fitojnë njohuri dhe të përvetësojnë strukturën gramatikore dhe semantike; -Të kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhësisë si shkencë;

Metodologjia për realizimin e temave mësimore:
Ligjërata, punime seminari, prezantime, punë kërkimore e hulumtuese, detyra, ushtime me shkrim e me gojë, diskutime, debate, konsultime etj.

Kushtet për realizimin e temës mësimore:			
Klasa, tabela, projektor, kompjuter, shkumës e marker, materiale të fotokopjuara etj.			
Mënyra e vlerësimit të studentit (në%)			
	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	
	Vijueshmëria ----10%		
	Punim seminari 5%		
	Detyra 5%		
	Testi gjysmësemestral 25%		
	Provimi përfundimtar 55%		
Obligimet e studentit:			
Ligjërata		Ushtrime	
Studentët kanë për detyrë të ndjekin rregullisht ligjëratat. Në mënyrë ndërvepruese të marrin pjesë në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe t'i kryejnë të gjitha detyrat që i jep mësimdhënësi.		Brenda orëve të ushtrimeve dhe me metoda ndërvepruese do të ketë pjesë të ushtrimeve për qartësi më të madhe që kanë të bëjnë me lëndën e <i>Gjuhësisë së përgjithshme</i> .	
Ngarkesa e studentit për lëndën			
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej:
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	1	15	15
Përgaditja e punimit të seminarit	1	15	15
Detyra –analizë gjuhësore	1	15	15
Parapërgaditja për testin e parë (gjysmësemestral) dhe të dytë (përfundimtar)	1	15	15
Konsultime	1	10	10
Parapërgaditja për testin (provimi) përfundimtar			
Vërejtje: 1 ECTS kredi=25 orë angazhim, lënda i ka 4 ECTS kredi studentit duhet t'i ketë angazhim gjatë semestrit 100 orë.		Ngarkesa totale:	100

Java	Ligjërata	Orët	Ushtrime	Orët
1.	Tema	2	Tema	1
	Lënda e gjuhësisë së përgjithshme -Njohuri të përgjithshme -Nocione të përgjithshme		Nocione themelore	
2.	Greqia e Lashtë dhe Roma	2	Alfabeti dhe shkrimi Shfaqjet e para të gjuhësisë. Periudha e kundërshtisë ndërmjet analogjistëve dhe anomalistëve. Analogjia-dukuri gjuhësore	1
	Mesjeta Skolastika Rilindja dhe më pas Lindja e shteteve kombëtare dhe gjuhët		Gramatika dialektika dhe retorika Gramatika spekulative Nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja te gjuhët e gjalla.	
4.	Pragu i kohës moderne Mendimi shkencor dhe gjuhësia	2	Wilhem Humbolti. Zbulimi i sanskritishtes dhe Gramatika e Paninit	1
	Gjuhësia historike dhe krahasuese në shek. XIX – Metoda krahasimtare		Tingujt, fonemat, fjalët, fjalitë, leksiku	
5.	Gjuhësia historike dhe krahasuese në shek. XIX – Metoda krahasimtare	2	Tingujt, fonemat, fjalët, fjalitë, leksiku	1

6.	Gjuhësia në shek XX Periudha e parë Ferdinand de Saussure dhe strukturalizmi		Zhvillimi gjuhësisë përshkruese Fonologjia	1
7.	Strukturalizmi dhe Shkolla e Pragës		Sweet, Jones dhe Shkolla e Pragës	1
8.	Test gjysmësemestral			1
9.	Gjuhësia amerikane		Boas, Spair, Bloomfield	1
10.	Njësitë gramatikore Paradigmatika dhe sintagmatika	2	Fjalët, fjalitë, morfemat, morfi dhe alomorfi, sintagmat	1
11.	Kategoritë gramatikore	2	Kategoritë gramatikore dhe leksikogramatikore	1
12.	Gjuhësia në shekullin XX Periudha e dytë Gramatika gjenerative	2	Kompetenca dhe performanca Struktura e thellë dhe sipërfaqësore	1
13.	Funksionet gramatikore	2	Gjymtyrët e fjalisë; Tema dhe rema	1
14.	Struktura semantike	2	Sinonimia, homonimia, hiponimia, antonimia, shumëkuptimësia	1
15.	Pronësia mbi gjuhën dhe kompetenca gjuhësore	2	Pragmatika	1

LITERATURA

Robert H. Robins, *Historia e gjuhësisë*, Tiranë, 2007.
 John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
 Shezai Rrokaj, *Filozofia e gjuhës*, Tiranë, 2010.
 Shezai Rrokaj, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Tiranë, 1994.
 Rami Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, 2008.

VËREJTJE

Mësimi mbahet sipas orarit zyrtar. Studentët duhet të prezantojnë në ligjërata.

Vërejtje për studentin:

Prezenca e studentëve në orën e mësimi u ndihmon atyre të nxënë dije për lëndën. Zhvillimi i lëndës me metodën interaktive i bën më të interesuar dhe më komunikues.